

FLETË UDHËZUESE E PAKETIMIT: INFORMACION PËR PËRDORUESIN

ADAPTOL 300 mg Kapsula të Forta

Mebikarum

Lexoni me kujdes gjithë fletën udhëzuese përpara se të përdorni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletë udhëzuese. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri atë.
- Në rast se keni pyetje të tjera, drejtohuni mjekut.
- Ky bar është përshkruar nga mjeku vetëm për ju. Mos ia jepni atë personave të tjerë. Ky veprim mund të jetë i dëmshëm për ata, edhe sikur simptomat e tyre të jenë të njëjta me tuajat.
- Në rast se ndonjë prej efekteve të padëshiruara bëhet serioz ose në rast se vëreni të shfaqen efekte të padëshiruara që nuk janë përshkruar në këtë fletë udhëzuese, njoftoni mjekun ose farmacistin

Në këtë fletë udhëzuese:

1. Çfarë është Adaptol dhe për çfarë përdoret
2. Përpara se të përdorni Adaptol
3. Si përdoret Adaptol
4. Efektet e padëshiruara të mundshme
5. Si ruhet Adaptol
6. Të dhëna të tjera

1. ÇFARË ËSHTË ADAPTOL DHE PËR ÇFARË PËRDORËT

Mebikar, lënda vepruese e produktit mjekësor Adaptol, bën pjese në një grupfarmakoterapeutik të njohur si “anksiolitikët”. Mebikar shfaq një veprim të moderuar anksiolitik (kundër ankthit), heq ose pakëson shqetësimin, ankthin, frikën, tensionin e brendshëm emocional tension dhe irritimin. Efektet anksiolitike të këtij produkti nuk shoqërohen nga veprime të tilla të padëshiruara si efekti miorelaksant apo çrregullimi i koordinimit të lëvizjeve apo frenimi i veprimtarisë mendore dhe fizike dhe, për pasojë, Adaptol mund të përdoret pa pasur nevojë që të ndërpritet puna apo studimet.

Ky produkt mjekësor nuk ka veprim të drejtpërdrejtë hipnotik (gjumëdhënës), por ai fuqizon veprimin e barnave gjumëdhënëse dhe normalizon procesin e gjumit kur ky është i çrregulluar. Mebikar gjithashtu lehtëson ose heq abstinencën nga nikotina.

Mebikar nuk shkakton shtim të humorit apo eufori, ndërkohë që gjatë përdorimit të tij nuk është vërejtur krijimi i vartësisë apo shfaqja e sindromës së abstinencës.

Adaptol përdoret në përputhje me indikimet e mëposhtme:

- Neuroza dhe çrregullime neurotike (ankth, paqëndrueshmëri emocionale, shqetësim, frikë)
- Kardialgji të shkaqeve të ndryshme, por që nuk kanë lidhje me sëmundjen iskemike të zemrës
- Për të përmirësuar tolerancën ndaj neuroleptikëve dhe tranquilizuesve (këto barna shkaktojnë depresion emocional, efekte të shprehura sedative dhe dobësi muskulare).
- Trajtimi kompleks që synon pakësimin e prirjes për të pirë duhan

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI ADAPTOL

Mos përdorni Adaptol

- në rast se jeni alergjik (i mbindjeshëm) ndaj mebikar dhe/ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë (ingredientëve) të Adaptol

Tregoni kujdes të veçantë me Adaptol

Nuk nevojiten përkujdesje të veçanta.

Përdorimi i barnave të tjerë

Jeni të lutur të njoftoni mjekun në rast se jeni duke përdorur ose para pak kohësh keni përdorur barna të tjerë, përfshi edhe barnat që merren pa recetë.

Adaptol mund të përdoret njëkohësisht me barna të tillë si neuroleptikët, trankuilizantët (benzodiazepinat), hipnotikët, antidepressantët dhe psikostimuluesit.

Përdorimi i Adaptol me ushqimin dhe lëngjet

Adaptol mund të merret pavarësisht nga ushqimi.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji

Këshillohuni me mjekun përpara se të përdorni çdo bar.

Përdorimi i këtij bari gjatë shtatzënisë dhe në periudhën e ushqyerjes së fëmijës me gji nuk është i këshilluar.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Ky produkt mjekësor mund të shkaktojë hipotension dhe dobësi, për këtë arsye, mund të ketë ndikim të dëmshëm mbi aftësitë tuaj për të drejtuar automjete ose përdorur makineri.

3. SI PËRDORET ADAPTOL

Adaptol gjithmonë duhet të përdoret ekzaktesisht sipas këshillës së mjekut.

Në rast se nuk jeni të sigurtë, këshillohuni me mjekun.

Adaptol mund të merret pavarësisht nga ushqimi.

Të rriturit: 300 mg 2-3 herë në ditë.

Doza e vetme maksimale është 3 g, doza ditore maksimale është 10 g.

Kohëzgjatja e trajtimit – nga pak ditë deri në 2-3 muaj.

Trajtimi kompleks për pakësimin e prirjes për të pirë duhan – 600-900 mg, 3 herë në ditë, për 5-6 javë.

Të moshuarit: dozat e mësipërme nuk kanë nevojë për përshtatje.

Pacientët me insuficiencë të mëlçisë: dozat e mësipërme nuk kanë nevojë për përshtatje.

Në pacientët me insuficiencë renale nuk është studiuar nevoja për përshtatje të dozave dhe, për këtë arsye, në këta pacientë ky produkt mjekësor duhet të përdoret me kujdes.

Në rast se keni përshtypjen që veprimi i barit është tepër i theksuar ose i mangët, këshillohuni me mjekun.

Në rast se merrni më shumë Adaptol nga sa nevojitet

Në rast keni marr më shumë kapsula Adaptol nga sa duhet, shkoni menjëherë te mjeku.

Në rast se harroni të merrni Adaptol

Në asnjë rast mos dyfishoni dozën me qëllim që të kompensoni dozën e harruar.

Në rast se ndërprisni marrjen e Adaptol

Mos ndërprisni përdorimin e Adaptol pa u këshilluar më parë me mjekun.

Në rast se keni ndonjë pyetje të mëtejshme për përdorimin e këtij produkti mjekësor, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET E PADËSHIRUARA TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat, edhe Adaptol mund të shkaktojë efekte të padëshiruara, ndonëse ato nuk shfaqen tek të gjithë personat që e përdorin atë.

Shpeshtësia e efekteve të padëshiruara

Çrregullime të sistemit nervor: të rralla – marrje mendsh.

Çrregullime vaskulare: të rralla – hipotension.

Çrregullime gastrointestinale: të rralla – çrregullime të tretjes.

Çrregullime të lëkurës dhe indit nën lëkurë: të rralla – pas marrjes së dozave të larta janë të mundshme reaksione alergjike (të kruara të lëkurës). Në rast të ndonjë reaksioni alergjik përdorimi i barit duhet të ndërpritet.

Çrregullime të përgjithshme dhe gjendje të vendit të administrimit: të rralla – hipotermi, dobësi. Në rastet e rënies së presionit të gjakut dhe/ose të uljes së temperaturës trupore (temperatura e trupit mund të ulet me 1-1.5 °C), përdorimi i barit nuk duhet të ndërpritet. Presioni i gjakut dhe temperatura e trupit normalizohen pas përfundimit të trajtimit.

5. SI RUHET ADAPTOL

Të mbahet në vende me temperaturë nën 25°C. Të mbrohet nga drita dhe lagështia.

Të ruhet në vende që nuk mund të shihen dhe të arrihen nga fëmijët.

Mos e përdorni Adaptol pas datës së skadencës të shënuar në paketim.

Barnat nuk duhet të hidhen në ujërat e zeza apo në mbeturinat e shtëpisë.

Pyetni farmacistin tuaj për mënyrën e trajtimit të barnave të panevojshëm.

6. TË DHËNA TË TJERA

Çfarë përmban Adaptol

Lënda vepruese është mebikar.

Çdo kapsulë përmban 300 mg mebikar.

Lëndë të tjera jo vepruese (ingredientë) janë: metilcelulozë, stearat kalciumi.

Përbërja e kapsulës: xhelatinë, dioksid titani.

Si paraqitet Adaptol dhe përmbajtja e paketimit

Përshkrimi: kapsula me xhelatin të fortë me ngjyrë të bardhë që përmbajnë pluhur pothuajse të bardhë. Prania e konglomerateve të grimcave ose formimi i tapave të pluhurit është e lejueshme.

Paketimi:

10 kapsula të futura në blister PVC- alumin.

Kuti kartoni me 2 blistera (20 kapsula) dhe një fletë udhëzuese.

Zotërues i Lejes së Tregëtimit dhe Prodhues

Emri i kompanisë:	Joint-Stock Company “Olainfarm”
Adresa:	5 Rupnicu Street, Olaine, LV 2114
Vendi:	Letoni
Telefoni:	+371-67013701
Telefaks:	+371-67013777
E-mail:	olainfarm@olainfarm.lv

Kjo fletë udhëzuese është miratuar për herë të fundit më: 09.2013.